



6919

02.12.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
HEKURUDHA SHQIPTARE sh.a  
ADMINISTRATORI

Nr. 1097 ProtDurrës, më 30 / 11 2022

**Lënda:** Zhvillimi i seancave informuese mbi përfitimet dhe përdorimin e sigurtë të transportit hekurudhor me mësuesit dhe nxënësit të arsimit parauniversitar përfshirë në projekt

*Ref: Projekti i Rehabilitimit të Linjës Durrës-Tiranë TTP dhe lidhja me Aeroportin Nënë Tereza*

**Drejtuar:** **Z. Blerim Shera**  
Kryetar i Bashkisë Vorë

Vorë

I nderuar Z. Shera,

Hekurudha Shqiptare (HSH) me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), është duke zhvilluar projektin "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Terminali i Transportit Publik të Tiranës dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore me Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit", referuar si Projekti HSH-së.

Me fillimin e zbatimit të projektit synohet rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjërë dhe grupeve të interesit për përfitimet e përdorimit të sigurtë të transportit hekurudhor në përgjithësi dhe masat e sigurisë në veçanti. Për këtë qëllim, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po mbështet Hekurudha Shqiptare sh.a., me asistencë teknike përmes projektit "Rritja e kapacitetit të shoqërisë civile për të promovuar përdorimin e sigurt dhe përfitimet e qëndrueshme të transportit hekurudhor në Shqipëri". Qëllimi i këtij projekti është bashkëpunimi teknik për promovimin e përdorimit të sigurtë dhe përfitimeve të transportit hekurudhor në Shqipëri si dhe fuqizimin e kapacitetit të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të përfshira në këtë projekt, ç'ka pritet që të influencojë ndryshime pozitive, në sjelljen e grupeve të synuara për përdorim të shtuar dhe të sigurt të transportit hekurudhor.

Një ndër grupet kryesore të interesit të identifikuar tek të cilat synohet të promovohet përdorimi i sigurtë dhe përfitimet e transportit hekurudhor janë banorët (përfshirë familjet dhe qytetarët e tjerë në nevojë) që banojnë në Njësitë Administrative që shtrihen brenda një korridorit prej 3km të gjërë përgjatë linjës hekurudhore Durrës-Tiranë-Rinas.

Këto Njësi Administrative, përfshirë fshatrat dhe lagjet në përbërjen e tyre (37 qendra të banuara në total, 3 qytete dhe 34 fshatra), janë identifikuar në kuadër të projektit të sipërcituar mbështetur nga BERZH dhe jepen të detajuara në dokumentin bashkëlidhur kësaj shkrese, veçmas për secilën prej bashkive të Qarkut Tiranë dhe Durrës.

Nën koordinimin dhe mbikqyrjen e stafit përfaqësues të Hekurudha Shqiptare sh.a. të autorizuar nga Administratori i hekurudhës shqiptare Z. Gentian Liko ( Zj. Gerta Kordalli, Koordinatore Marketingu në mardhënie me publikun | tel +355692352217 | email: [gerta.kordalli@hekurudha.al](mailto:gerta.kordalli@hekurudha.al), Z. Eriton Hasaj | tel: +355672221452 | email: [eriton.hasaj@hekurudha.al](mailto:eriton.hasaj@hekurudha.al)), ekspertët e projektit (znj. Brikena Tare dhe znj. Ledina Gjikhuri) së bashku me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të përzgjedhura në konsultim me BERZH (sipas fushës së tyre të veprimtarisë dhe bashkëpunimet e mëparshme me institucionet e pushtetit vendor) dhe të trajnuara nga projekti për këtë qëllim, përkatësisht:

- ALCDF - Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (zj Lindita Manga, person përgjegjës)
- AWEN - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (znj. Marinela Seitaj dhe znj. Erisilda Shpara, persona përgjegjës)

është e nevojshme që të zhvillojmë takime pune -në formën e seancave informuese/shpjeguese- me drejtuesit dhe stafin e strukturave bashkiake që janë në kontakte të vazhdueshme me komunitetin e qendrave të banuara që ndikohen nga punimet rehabilituese të linjës hekurudhore Durrës-Tiranë. Takime parashikohen të zgjasin rreth 1 orë gjatë të cilave ekspertët e sipër përmendur do të mund të informojnë stafin e Bashkisë mbi përdorimin e sigurtë dhe përfitimet e transportit hekurudhor në Shqipëri dhe të vënë në dispozicion të tyre një kopje të materialeve informuese (broshura, fletpalosje dhe postera) të pregatitur në kuadër të projektit, versionet elektronike të së cilës gjenden të publikuara në portalin e Hekurudha Shqiptare sh.a. (<https://hekurudha.al/dokumenta/>).

Për sa më sipër, nevojitet bashkëpunimi juaj për të mundësuar mbajtjen e dy takimeve në ambientet e bashkive përkatëse në datat e propozuara si më poshtë:

- Takimi më datë 13 dhjetor 2022 ora 10:00 me drejtuesit dhe stafin e strukturave bashkiake që mbulojnë çështjet e informimit publik, zhvillimit urban dhe kryeploqtë;
- Takimi më datë 12 dhjetor 2022 ora 13:00 me drejtuesit dhe stafin e strukturave bashkiake që mbulojnë ndihmën ekonomike, mbrojtjen e fëmijëve (aty ku ka punonjës të tillë) si dhe administratorët socialë,


Nëse data/ora e sugjeruar për takimet e nevojshme është e pamundur për stafin tuaj, lutemi sugjeroni kohën tuaj më të përshtatshme.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicionin tuaj për çdo informacion tjetër të nevojshëm dhe shpresojmë të përmbyllim fushatën informuese/ndërgjegjësuere me stafin e bashkive brenda këtij viti.

Me respekt,

## ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Gentian LIKO





REHABILITIMI I  
HEKURUDHËS DURRËS-TIRANË  
DHE SEGMENTI I RI DOMJE-RINAS

**HSH**

**HEKURUDHA  
SHQIPTARE**



hekurudha.al

**TRENI PO VJEN!**

**MË MIRË ME TREN**

Materiali u përgatit nga dhe nën përgjegjësinë e HBMC,  
kontraktuar nga BERZH për zbatimin e Projektit

**SIGURIA dhe  
PËRPARËSITË e  
qëndrueshme të  
TRANSPORTIT  
HEKURUDHOR  
në Shqipëri**



**KUJDES NGA TRENI!**

"Fuqizimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për të nxitur përdorimin  
e qëndrueshëm dhe të sigurtë të transportit hekurudhor në Shqipëri"

TRANSPORTI lehtëson komunikimin dhe shkëmbimet midis njerëzve në aktivitetet jetësore, duke zhvilluar ekonominë.

TRANSPORTI PUBLIK mundëson lëvizje dhe akses për shkëmbime, punësim, shërbime, kujdes mjekësor dhe aktivitete të tjera, për të gjithë dhe në gjithë vendin.

TRANSPORTI HEKURUDHOR rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së qytetarëve.

## transporti Hekurudhor

### Sjell zhvillim

- ✦ Rrit volumin duke ulur kostot e transportit të pasagjereve dhe mallrave.
- ✦ Ndhmon shkëmbimet tregtare duke rritur aksesin në tregjet e mallrave dhe shërbimeve
- ✦ Lehtëson komunikimin midis njerëzve të çdo niveli, statusi apo grupmoshe për aktivitetet familjare, sociale, kulturore, argëtim apo turizëm.

Hap vënde të reja pune si dhe krijon hapësirë ekonomike vetëpunësimi.

### Mbron Mjedisin

- ✦ Treni është transporti më miqësor me mjedisin. Dëmi mjedisor që lidhet me zhurmat, ndotjen e ajrit, aksidentet, ndikimin në territor është më i ulët se në transportin rrugor.
- ✦ Transporti hekurudhor shkarkon 75% më pak gazra të dëmshme në atmosferë krahasuar me transportin rrugor.
- ✦ Me pak mjete motorike në rrugë, më pak trafik e ndotje, më pak zhurma e stres. Më shumë shëndet, ajër të pastër dhe cilësi jete.

*Të udhëtosh me tren është mënyra më e mirë për të arritur shpejt në destinacion, duke kursyer para dhe mbrojtur mjedisin. Përparësitë e hekurudhës e bëjnë udhëtimin me tren një zgjedhje të preferuar për transport në të gjithë botën.*

## MË MIRË ME TREN.

### Treni është:

#### I BESUESHËM

*Me tren mbërrini gjithmonë në destinacion!*

Treni ka orare dhe kohëzgjatje të caktuara operimi  
Udhëtimi me tren nuk ndikohet nga trafiku, moti, orët e ditës etj.

Oraret e trenave janë të paracaktuara dhe të publikuara.  
Mund të organizoni e planifikoni udhëtimin tuaj.

#### I REHATSHËM

*Në tren keni rehatinë dhe kohën!*

Me tren mund të udhëtoni kur jeni të lodhur, të impenjuar, apo keni konsumuar alkool pa patur frikë se "ju zë treni"

Në tren keni më shumë hapësirë për vete dhe bagazhet

Kohën e udhëtimit me tren mund ta perdorni për:

Punë	Argëtim	Shoqërizim	Qetësim
Përdor celularin, laptopin apo bllokun e shënimeve!	Lexo libër, dëgjo muzikë, shiko filmin apo shfaqjen që do!	Bisedo apo luaj me miqtë, familjarët apo bashkudhetarët!	Merr një sy gjumë, medito, apo shijo natyrën!

#### EKONOMIK

*Me tren ju del më lirë!*

Duke qenë se trenat kanë kapacitet më të madh si për pasagjerë edhe për mallra ata janë mënyra më ekonomike e transportit.

Një biletë udhëtimi me tren do t'ju kushtojë shumë më pak se sa të udhëtoni me makinën tuaj personale.  
Çmimi i biletës nuk ndryshon kur rritet çmimi i karburantit.

#### I SIGURT

*Jeta është më e sigurt në tren!*

Treni është mënyra më e sigurt e transportit.

Me autoveture jeni **24 herë** më tepër të rrezikuar  
Me autobusi jeni **2 herë** të pësoni aksident.

#### I SHPEJTË

*Me tren nuk do të jeni asnjëherë vonë!*

Duke udhëtuar me tren do të arrini më shpejt në destinacion pasi treni:

Ka rrugën e vet të cilën nuk e ndan me mjetet e tjera.

Ecën me shpejtësi të njëjtë në çdo kohë pa u ndikuar nga ngarkesa apo trafiku.

#### I INTEGRUAR

*Me tren itineraret janë fleksibël!*

Si pjesë e transportit intermodal, treni lidh qendrat urbane me njëra-tjetrën si dhe me nyjet e tjera të transportit si portet e aeroportet.

Stacionet e trenave janë gjithashtu pika referimi për shërbimet e tjera të transportit (autobus, taxi, parkim).

Në tren mund të merrni me vete edhe biçikletën tuaj.

**Treni VS Vetura**  
Trafik i bllokuar VS Mendja e çliruar

**Ktheje faqen!**  
Drejto makinën! VS Media sociale

**Thirrje e humbur VS Shiko rrugën!**  
Shijo natyrën!

**Bjeri borisë! VS Lëkundu në gjumë!**

**Udhëtimi Tiranë - Durrës**

**34 km**  
26 minuta  
200 lek  
sh.m. 80km/h


**34 minuta**  
450 lek  
sh.m. 65km/h

**43 minuta**  
300 lek  
sh.m. 50km/h

**36 km**  
7 orë  
12 min.  
sh.m. 5km/h

**Kush udhëton me TREN?**

31% individët  
47% familjet me femijë  
24% çifet



**Me TREN mund të udhëtoni NË ÇDO KOHË**

ditë, natë, ditë, natë

**nd të transportohen 1000 udhë**

me 1 Tren me 8 vagonë  
me 15 Autobusë  
me 250 Autovetura

**38 UDHËTARË MOTOÇIKLETE**



**2.7 UDHËTARË AUTOVETURE**

**0.23 UDHËTARË AUTOBUSI**

**0.1 UDHËTARË TRENIT**

**0.06 UDHËTARË AVIONI**

Numri i fataliteteve për 1 miliardë udhëtarë/km



**HSH****HEKURUDHA SHQIPTARE****TRENI PO VJEN!****SIGURIA PËR QYTETARËT  
NË NDËRVEPRIM ME BINARËT****TRENI PO VJEN!**

*Për të patur më pak incidente dhe më pak jetë të humbura është e rëndësishme të inkurajojmë qëndrime të përgjegjshme, të nxisim një sjellje të sigurt te qytetarët e të gjitha moshave lidhur me respektimin rregullave shenjave dhe paralajmërimeve në ndërveprimin me hekurudhën dhe trenat.*

**VLERAT THEMELORE** të një sistemi hekurudhor janë ruajtja e shëndetit dhe mjedisit shoqëror, siguria e jetës së qytetarëve dhe qëndrueshmëria ekonomike.

#### **KËTO VLERA JANË TË NDËRVARURA.**

Vetëm një hekurudhë e sigurt dhe e qëndrueshme ekonomikisht është në gjendje të modernizohet që të garantojë sigurinë e jetës, shëndetit dhe mjedisit për qytetarët.

Ndërsa një hekurudhë e pasigurt dhe e rrezikshme nuk do të arrijë të jetë e qëndrueshme dhe funksionale në planin afatgjatë.

#### **SIGURIA HEKURUDHORE ËSHTË NJË PËRGJEGJËSI E PËRBASHKËT.**

**Ndryshimi i sjelljes së qytetarëve ndaj hekurudhës dhe trenave kërkon:**

**Zbatimin e ligjeve** që rregullojnë funksionimin e sistemit hekurudhor;

**Modernizimin e infrastruktures** dhe sistemeve të sigurisë;

**Edukimin e njerëzve për përgjegjësitë e tyre** lidhur me respektimin e rregullave të ndërveprimit me trenat dhe shinat e hekurudhës.

*Çdo vit, shumë njerëz në botë vdesin ose pësojnë lëndime serioze nga incidentet hekurudhore apo përplasjet në vendkalime.*

**Edukimi i njerëzve për rregullat e sigurisë** që lidhen me hekurudhën dhe lëvizjen e trenave, është mjeli i duhur për t'i bërë të vetëdijshëm për rreziqet me pasoja të rënda që lidhen me incidentet e mundshme në vendkalimet dhe binarët e hekurudhës



Siguria hekurudhore në Shqipëri garantohet nga Kodi i ri Hekurudhor. Kodi kushtëzon perdorimin e Metodave të Përbashkëta të Sigurisë (të detyrueshme në vendet e BE) për operimin e sigurt të trenave. Metodat e Përbashkëta të Sigurisë përshkruajnë sesi duhen zbatuar



#### **SISTEMET E SIGURISË NË LINJËN HEKURUDHORE DURRËS-TIRANË-RINAS**


Segmenti i rehabilituar hekurudhor Durrës-Tiranë dhe segmenti i ri Domje-Rinas, nëpërmjet aplikimit të sistemeve moderne të administrimit dhe sigurisë, do të arrijë Nivelin e Integruar të Sigurisë SIL 4, (sipas EN 50129-Standardi European për sistemet e sigurisë dhe sinjalizimit hekurudhor), standard që përdoret nga operatorët europianë.

**Plani i Sigurisë së Hekurudhës** përveç Sistemit të Telekomanduar të Sinjalizimit nga Qendra e Kontrollit në Shkozet që do të operojë sistemin elektronik të kontroll-komandimit parashikon:

- ❖ Rrethimin me Gardh Mbrojtës të Linjës Hekurudhore
- ❖ Sistemet Automatikë të Mbrojtjes në Vendkalimet e Autorizuara.

#### **RRETHIMI I PLOTË ME GARDH MBROJTËS I HEKURUDHËS DURRËS-TIRANË-RINAS**

*Hekurudha sot përdoret shpesh nga banorët përreth si vendkalimi i shkurtër për këmbësorët dhe automjetet, si vend lojrash për fëmijët apo si kullotë për haqëtitë dhe kafshët shtëpiake.*



Rrethimi mbrojtës i linjës Durrës-Tiranë-Rinas do të mundësojë:

- Lëvizjen e papenguar të trenave të linjës nga kalimi arbitrar i këmbësorëve e automjeteve dhe qarkullimi i kafshëve,
- Parandalimin e aksidenteve me pasoja ndaj jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit,
- Krijimin e distancës së sigurisë nga binarët për njerëzit kafshët dhe mjetet e zonave përreth.


Rrethimi i hekurudhës do të mbyllë të gjitha kalimet e paautorizuara. Kalesat e autorizuara do të pozicionohen në përputhje me mundësitë e rrugëve alternative. Kanalet dhe urat e hekurudhës do krijojnë mundësi të pranueshme për lëvizjen e kafshëve.




#### **VENDKALIMET E AUTORIZUARA (KALIMET NË NIVEL)**

**KALIMET NË NIVEL** janë pika kritike në rrjetin hekurudhor, pasi ato përfaqësojnë një rrezik të qenësishëm për sigurinë e përdoruesve të rrugës dhe hekurudhës.

Të dhënat historike tregojnë se çdo lloj mbrojtjeje është më e mirë se asgjë, vetëm sistemet manuale dhe me tra mbrojtës të kalimit në nivel e zvogëlojnë rrezikun e një aksidenti drejt zeros.





Pavarësisht nëse jeni duke ecur, duke ngarë automjetin a motoçikletën, ose jeni me biçikletë, patina, monopatinë, rrotabord apo karrocë lëvizëse, kur jeni pranë binarëve, trenave apo kryqëzimeve hekurudhore, QËNDRONI VIGJËLËNTË dhe VEPRONI ME SHUMË KUJDES. SIGURIA JUAJ PRANË BINARËVE LIDHET VETËM ME NJOHJEN DHE ZBATIMIN E RREGULLAVE.

**RESPEKTONI RREGULLAT SE MUND T'JU SHPËTOJNË JETËN!**

**Kur kapërceni shinat e treni sigurohuni të kryeni këto veprime:**

- 1 NDALO** kur shikoni dritat që pulsojnë dhe dëgjon kumbimin e ziles Qëndro pas vijës së bardhë
- 2 PRIT** nëse sinjalet vazhdojnë edhe pasi treni ka ikur, një tren tjetër mund të kalojë përsëri.
- 3 KALO** vetëm kur sinjalet ndërpriten dhe hapen pengesat

**KËSHILLA GJATË KALIMIT TË KRYQËZIMIT HEKURUDHOR**

**Për KËMBËSORËT**



Duhet të kuptoni rreziqet e mundshme.

Tundimi	Është joshëse të kapërceni apo anashkaloni barrierat në vend që të prisni trenin të kalojë. Mos e bëni, rrezikon jetën.
Supozimi	Mos supozoni se ka vetëm një tren ose mendoni se nuk kalon treni në këtë orë Treni mund të vijë nga çdo drejtim e në çdo kohë.
Kafshët	Nëse qeni ju shpëton nga kontrolli dhe vrapon drejt shinave, mos vraponi pas tij.
Shpërqëndrimi	Është e lehtë të shpërqëndroresh, sidomos nga telefonat, muzika dhe biseda. Nëse jeni në grup mos mendoni se dikush tjetër po sigurohet për ju

Gjatë kalimit të kryqëzimit si këmbësorë:

- Përqëndrohu!** Ndërpri telefonat, muzikën e bisedat!
- Ndalo, shiko dhe dëgjo!** Respektoni shenjat dhe sinjalet!
- Kontrollotë dy anët** para se të kalosh, nëse sheh një tren që vjen, MOS KALO!
- Kupto sinjalistikën** shenjat, dritat, barrierat dhe alarmet!
- Kalo shpejt** duke mbajtur fëmijët në kontroll dhe kafshët të lidhura!



**MOS HARRONI!**

- ✦ Trenat zakonisht udhëtojnë me një shpejtësi mesatare prej 80 km/orë.
- ✦ Një tren peshon rreth 400 ton që është e barabartë me 80 elefantë.
- ✦ Që nga momenti i frenimit trenit i duhet rreth 1.5 km që të ndalojë plotësisht. Kjo distancë është sa 15 fusha futbolli!
- ✦ Është e vështirë të përcaktoni shpejtësinë dhe largësinë e trenit nga ju. Trenat janë zakonisht më afër, udhëtojnë më shpejt dhe bëjnë më pak shurmë se sa duket.
- ✦ Kur treni përplas një autoveturë është sikur një autoveturë të godasë një kanaçe pijesh.
- ✦ Trenat janë më të gjerë sesa binarët ata mund të shkojnë deri 1m në çdo anë. Respektoni distancën e sigurisë kur jeni afër shinave.
- ✦ Trenat mund të lëvizin në të dy drejtimet pavarësisht se kanë lokomotivën në njërin anë. Lëvizjet e trenave janë të paparashikueshme, është i rrezikshëm kalimi midis vagonëve të një treni që ka ndaluar.
- ✦ Kalimet e mbrojtura të hekurudhës janë për të na ruajtur dhe jo për të na harxhuar kohën. Ato shpëtojnë jetë. njerëzish.
- ✦ Kur shikoni shinat mendoni trenin, në çdo moment mund të jete duke kaluar një tren.
- ✦ Shinat janë të trenit e jo për njerëzit! Është me rrezik të ecni apo të luani përgjatë shinave.

**Për DREJTUESIT E MJETEVE MOTORRIKE**



Duhet të kuptoni rreziqet e mundshme.

Tundimi	Është joshëse të neglizhoni sinjalet, të anashkaloni barrierat apo të garoni me trenin për të arritur më parë në kryqëzim. Mos e bëj! - po rrezikon jetën.
Supozimi	Mos supozoni se ka vetëm një tren ose mendoni se nuk kalon tren në këtë orë Trenat mund të vijnë nga secili drejtim dhe në çdo kohë.
Dalja e Bllokuar	Është çuditërisht e lehtë të ngeçesh mbi shina. Sigurohuni që dalja të jetë e lirë përpara se të kaloni kryqëzimin.

Gjatë kalimit të kryqëzimit si drejtues mjeti:

- Përgatitu** të ndalosh përpara kryqëzimit!
- Kupto sinjalistikën** shenjat, dritat, barrierat dhe alarmet!
- Ndalo** kur sinjalet aktivizohen nëse nuk keni kaluar vijën STOP/NOSTOP!
- Qëndro** palëvizur derisa sinjalet të ndalojnë!
- Kontrollo** që dalja në krahnun tjetër është e lirë përpara se të kaloni matanë!



**Për BIÇIKLISTËT**



Duhet të kuptoni rreziqet e mundshme.

Tundimi	Është joshëse të kapërceni apo anashkaloni barrierat në vend që të prisni trenin të kalojë. Mos e bëni, rrezikon jetën.
Supozimi	Mos supozoni se ka vetëm një tren ose mendoni se nuk kalon treni në këtë orë Treni mund të vijë nga çdo drejtim e në çdo kohë.
Kafshët	Ekziston rreziku i bllokimit të rrotë në shina, sidomos kur duhet ti kaoni shinat pjerrëtas. Mund të jetë më mirë të zbritni dhe eci matanë.
Shpërqëndrimi	Është e lehtë të shpërqëndroresh, sidomos nga telefoni dhe muzika. Nëse jeni grup mos mendoni se dikush tjetër po sigurohet për ju.

Gjatë kalimit të kryqëzimit si biçiklist:

- Konsidero të zbersësh** nga biçikleta dhe të ecësh, veçanërisht kur do ti kaloni shinat pjerrëtas!
- Respekto shenjat** dhe rregullat dhe sinjalet!
- Kontrollo të dy anët** përpara se të kalosh! nëse treni po vjen, mos kalo!
- Qëndro** derisa të ndalojnë të gjitha sinjalet!
- Sigurohu** që rruga është e lirë para se të kalosh!



# SISTEMET E MBROJTJES NË VENDKALIMET E AUTORIZUARA.

**KUJDES NGA TRENI!**



Sinjalet pasive dhe pajisjet aktive të kontrollit të trafikut instalohen përgjatë rrugës që kryqëzohet me hekurudhën, në afërsi dhe në kryqëzimin e kalimit në nivel. Ato paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve dhe këmbësorët mbi praninë e shinave hekurudhore dhe mundësinë e kalimit të trenit. Këto sisteme

## SHENJAT DHE SINJALET PËR PËRDORUESIT E RRUGËS

### SHENJAT PASIVE paralajmërojnë dhe tregojnë kryqëzimin e rrugës me shinat.

#### SHENJAT PARALAJMËRUESE



Kryqëzim me hekurudhën



Kalim në Nivel Me Barriera



Kalim në Nivel Pa Barriera

#### SHENJAT TREGUESE



Kalim në Nivel Me 1 & 2 Trase



Shenja STOP!



Shenjë Përparësie



Sinjalistikë horizontale në rrugë

Këto shenja vendosen në rrugë përpara kalimit në nivel që të njoftojnë drejtuesit e mjeteve se rruga kryqëzohet me shinat hekurudhore dhe ti kujtojnë se duhet të ngadalësojnë.

Këto shenja vendosen në kalimet në nivel për të treguar vendndodhjen e kalimit dhe distancën e sigurisë nga shinat si dhe për të kujtuar drejtuesit e mjeteve se duhet të ndalojnë e të respektojnë përparësinë e trenit.

#### SHENJA TË TJERA



Ndalim Kalimi mbi shina



Stacion Treni

### SINJALET AKTIVE - tregojnë afërsinë e lëvizjes së trenave në hekurudhë



Semafor Pulsues me ose pa sinjal zanor dhe shenja e kryqëzimit me shinat



Barrierë dhe Semafor Pulsues me ose pa sinjal zanor dhe shenja e kryqëzimit me shinat

**BORIA E TRENI**  
ka për qëllim të lajmërojë afrimin e trenit. Treni gjithmonë i bie borisë kur i afrohet kalimit në nivel, kur hyn dhe del nga në një tunel si dhe në situata emergjente.

**FENERËT DHE SINJALET**  
e lokomotivës janë të ndezura kur treni është në lëvizje si gjatë natës ashtu dhe gjatë ditës.

## RREGULLAT E VEPRIMEVE NË KALIM NË NIVEL

### SINJALET AKTIVE

#### BARRIERA RRUGORE

Kur treni është duke u afruar Barriera ulet bashkë me aktivizimin e semaforëve dhe sinjalit zanor. Nuk duhet të kaloni edhe nëse nuk e shifni trenin. Qëndroni deri kur sinjalet ndalojnë e barriera ngrihet.

**KUJDES:** Është e rrezikshme dhe e paligjshme të anashkaloni barrierën kur është e ulur

#### SEMAFORËT PULSUES & SINJALI ZANOR

30 sekonda përpara se treni të mbërrijë në kryqëzim semaforët fillojnë të pulsojnë në mënyrë alternative dhe Zilja fillon të tringëllojë për të treguar afrimin e trenit. Duhet të ndaloni kur sinjalet aktivizohen dhe të qëndroni derisa ata të ndalojnë.



### SHENJAT PASIVE

#### VIJËZIMET E RRUGËS

RXR në rrugë tregon që jeni pranë kryqëzimit me shinat.

#### Vija STOP/NO STOP

Është një vijë e gjerë horizontale 5m larg shinave dhe tregon distancën e sigurisë nga shinat kalon treni. Kur sinjalet paralajmërojnë afrimin e trenit duni të ndaloni përpara kësaj vije. Në rast se e keni kaluar këtë vijë duhet të vazhdoni të kapërceni kryqëzimin.

**KUJDES!** Sigurohuni që ka hapësirë të mjaftueshme matanë shinave përpara se ta kaloni këtë vijë

#### SHENJA KRYQËZIMIT (2 trase)

Tregon vendodhjen e kryqëzimit dhe PËRPARËSINË e trenit në kryqëzim.

#### RRUGË ME DISNIVEL

Paralajmëron, kalimtarët, ciklistët, patinatorët, etj. se mund të pengohen dhe të ngecin në kryqëzim.

Shenja KALIM ME BARRIERA  
Tregon se rruga kryqëzohet me hekurudhën që ka 2 trase dhe kryqëzimi është i brojtur me barriera



#### Shenja NJOFTIMIT NË DISTANCË

Kjo është shenja e parë që vini re kur i afroheni kryqëzimit me shinat Ngadalësoni, qëndroni vigjilentë.

Ekzistojnë dy lloje të kalimeve në nivel:


- Kalimet në nivel brenda kufijve të stacioneve.
- Kalimet në nivel që janë jashtë kufijve të stacioneve, në linjën e hapur.

Të gjitha kalimet në nivel në linjën hekurudhore Durrës-Tiranë-Rinas do të kenë sinjale paralajmëruese (sinjale rrugore ose këmbësorësh (semafor), sinjale hekurudhore, barriera, sinjale zanore, etj).

Bazuar në nevojën për qarkullimin e automjeteve dhe qytetarëve, hekurudha Durrës-Tiranë-Rinas do të ketë 19 kalime rrugore dhe 5 kalime vetëm për këmbësorët.

Kalimet në nivel me rrugën automobilistike do të jenë të pajisura me barriera të automatizuara, semaforë pulsues dhe sinjale zanore paralajmëruese, ndërsa kalimet për këmbësorët do të përmbajnë barriera të plota, sistem paralajmëruese me drita dhe sinjal zanor si dhe pengesa për të parandaluar kalimin e automjeteve rrugore.

Të gjitha kalimet në nivel do të kenë të vendosura platforma kalimi me rampa të pjerrëta të përshtatshme për përdorimin e mjeteve lëvizëse të Personave me Aftësi të Kufizuar në përputhje me "Specifikimet Teknike për Ndërveprim për Personat me Aftësi të Kufizuar (PRM TSI)" të BE.





# DISA REGULLA DHE KËSHILLA PRAKTIKE PËR SIGURINË E QYTETARËVE PRANË SHINAVE DHE TRENAVE

## KUJDES NGA TRENI!

Aksidentet kryesore ndodhin me këmbësorët dhe drejtuesit e mjeteve që kalojnë shinat në mënyrë të pasigurt dhe më tepër ndodhin në vendkalimet në nivel.

### KËSHILLA PRAKTIKE PËR KËMBËSORËT



**QËNDRO LARG SHINAVE!**  
Kurrë mos ecni, luani, ngisni biçikletën motorin apo automjetin përgjatë shinave, Është e vështirë të gjykohe largësinë apo shpejtësinë e trenit që po kalon.



**RUAJ PRONËN HEKURUDHORE**  
Traseja, tunelet dhe urat janë pronë e Hekurudhës. Përdorja e tyre për qëllime të tjera nga njerëzit është jo vetëm shumë e rrezikshme por edhe e dënueshme. Tunelet dhe urat janë pak më të gjera se shinat, duke lënë pak vend për ju nëse treni vjen.



**RESPEKTONI SHENJAT & SINJALET**  
Zbatoni të gjitha rregullat e treguara nga shenjat dhe pajisjet paralajmëruese. Përpara se të kapërceni shinat, shikoni në të dy anët dhe dëgjoni nëse treni po afrohet. Nëse treni po vjen, apo sinjalet aktivizohen, ndaloni pas portës ose 5m larg nga shinat dhe prisni që treni të kalojë. Kaloni vetëm kur sinjalet të kenë pushuar dhe jeni siguruar se asnjë tren tjetër nuk po afrohet.



**PERDOR KALIMET E LEJUARA**  
Kaloni gjithmonë shinat në kalimet e caktuara. Kapërcimi i binarëve kudo tjetër mund të jetë vdekjeprurës. Kujdes, treni mund të vijë nga cilido drejtim e në çdo kohë, nuk ka një orar të caktuar.



**RUAJ DISTANCËN E SIGURISË**  
Trenat e tejkalojnë gjërësinë shinave me deri 1m në secilën anë. Ata mund të transportojnë ngarkesa që janë më të gjera se vagonët ju mund të goditeni gjithashtu nga zinxhirë, litarë apo nga vorbullat e ajrit nëse jeni shumë afër. Respektimi i distancës së sigurisë ju shpëton jetën.



**QËNDRONI VIGJËLENTË**  
Ju nuk mund ta shmangni goditjen nga treni nëse nuk e dëgjoni apo e shihni atë. Trenat sot ecin shpejt e bëjnë pak zhurëm. Trenat i bien borisë në vendkalime, ose raste emergjence, por ju nuk do ta dëgjoni nëse keni kufje. Mos u shpërqendroni nga celularët e pajisjet e tjera kur jeni pranë shinave apo kalimit hekurudhor.

### KËSHILLA PRAKTIKE PËR DREJTUESIT E MJETEVE



**MËSONI SHENJAT DHE SINJALET**  
Shenjat hekurudhore dhe pajisjet paralajmëruese janë instaluar përgjatë rrugëve dhe në kalimet hekurudhore për të paralajmëruar shoferët dhe komanduar trafikun. Ato shpëtojnë jetë, prandaj duhet ta dini se çfarë tregojnë e parajmërojnë ato.



**SHIKONI DHE DËGJONI PËR TRENIN**  
Kur i afroheni kalimit hekurudhor, ulni shpejtësinë, shikoni e dëgjoni në dy anët, ndaloni muzikën e bisedat dhe hapin dritaret për të dëgjuar më mirë trenat që afrohen. Nëse treni po vjen, ndaloni përpara, vijës STOP, ose 5m nga shina më e afërt dhe prisni që treni të kalojë.



**QËNDRONI VIGJËLENTË**  
Ju nuk mund ta shmangni goditjen nga treni nëse nuk e dëgjoni apo e shihni atë. Mos përdorni celularin e pajisje të tjera gjatë drejtimit të mjetit, sidomos pranë kalimit hekurudhor. Trenat sot janë të shpejtë e bëjnë më pak zhurëm, kështu që nëse shpërqendroheni, ju po vendosni jetën tuaj dhe jetën e udhëtarëve tuaj në rrezik.



**RESPEKTONI SHENJAT & SINJALET**  
Zbatoni të gjitha rregullat e treguara nga shenjat dhe pajisjet paralajmëruese. Në kalimet me pajisje aktive, qëndroni derisa barrierat të ngrihen dhe sinjalet të ndalojnë. Përpara se të vazhdoni, sigurohuni që nuk ka trena të tjerë dhe që të keni pamje të qartë të shinave. Nëse sinjalet aktivizohen, ose barrierat fillojnë të ulen kur ju i keni kaluar ato, MOS U NDALNI!



**ASNJËHERË MOS GARONI ME TRENIN**  
Nxiltimi për të kapërcyer vendkalimin përpara trenit mund t'ju kushtojë jetën. Është e vështirë të gjykoheh largësia apo shpejtësia e trenit që ndonjëherë arrijn deri 160 km/h. Treni i duhet më shumë sesa 1 km për të ndaluar, për më tepër ju e kapni drejtuesin e trenit të papërgatitur për të frenuar në kohe.



**KUJDES KALIMTARËT E TJERË NË RRUGË**  
Jini të vetëdijshëm se biçikletat apo mjetet e tjera me rrota lëvizin më ngadalë, dhe mund të kenë nevojë për hapësirë shtesë në një kalim hekurudhor. Gjithashtu, autobusëve shkollorë apo mjeteve të tjera mund t'u duhet të ndalojnë përpara kalimit hekurudhor prandaj duhet të përgatiteni të ndaloni.




**ABANDONONI MJETIN KUR FIKET OSE NGEÇ MBI SHINAT E VENDKALIMIT**  
Një makinë mund të prishtet në çdo kohë e nëse kjo ndodh mbi shinat e hekurudhës, mund të jetë vdekjeprurës. Nëse automjeti juaj fiket ose bllokohet mbi shina, dilni menjëherë jashtë tij bashkë me pasagjerët dhe largohuni të paktën 30 metra nga shinat. Njoftoni kompaninë hekurudhore se automjeti është mbi shina (numri i urgjencës mund të jetë i afishuar) përndryshe telefononi Emergjencën Civile.


- ♣ Bëni më tepër kujdes natën dhe gjatë dimrit. Errësira, mjegulla dhe rreshjet mund të ulin shikimin dhe dëgjimin.
- ♣ Një automobilist është 40 herë më i rrezikuar të vdesë nga një përplasje me trenin sesa me një mjet tjetër motorik.



### KËSHILLA PËR FËMIJËT




Kapërceni shinat vetem në vendet me shenjen X! Largohuni sa më shpejt nga shinat nëse degjoni borinë e trenit!




Mos qëndroni mbi shina. Kur trenisti ju sheh është shumë vone për të ndaluar. Shinat janë për trenin jo për lojra.




Kurrë mos i bini rrugës shkurt përmbi shina.




Mos hyni dhe mos kaloni brenda tuneleve të hekurudhës!



Mos kaloni dhe mos luani mbi urat e hekurudhës!




Mos vendosni sende të forta mbi shinat e trenit. Është e rrezikshme!



Mos luani mbi vagonet dhe mos kaloni midis tyre edhe kur treni ka ndaluar!



Mos qelloni me gure trenin se rrezikoni pasagjerët! Ata mund të jenë familjarët tuaj.

**HSH****HEKURUDHA SHQIPTARE****TRENI PO VJEN!**

## HEKURUDHA DURRËS-TIRANË DHE SEGMENTI DOMJE I/C-RINAS

Rehabilitimi i linjës ekzistuese hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimi i segmentit të ri Domje I/C – Rinas do të mundësojë një shërbim transporti hekurudhor më të shpejtë dhe më të rregullt midis Tiranës, Durrësit dhe Aeroportit “Nënë Tereza” dhe do të përmirësojë aksesin në zonat përreth linjës.

Do rehabilitohen 34.2 km të trasesë së bashku me stacionet ekzistuese dhe do të ndërtohet Terminalit i ri i Transportit Publik (TTP) të Tiranës si një nyje multi-modale e transportit publik të Tiranës. Gjithashtu, do të ndërtohet 4.7 km segment i ri hekurudhor Domje I/C - Rinas së bashku me Terminalin e ri të Rinasit dhe një stacion të ri në zonën e Universitetit Epoka. Ky segment do të mundësojë lidhjen me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Për të garantuar lëvizjen e papenguer të trenave dhe sigurinë e qytetarëve, e gjithë traseja e linjës hekurudhore, përveç kalimeve të autorizuara, do të rrethohet me gardh mbrojtës. Kjo do të bëjë që të mbyllen 9 vendkalime të paautorizuara (shih hartën).

6 kalimet e autorizuara ekzistuese dhe 3 kalimet e reja, që do ndërtohen në segmentin Domje I/C-Rinas, do të jenë të mbrojtur me gjysmë barriera të automatizuara dhe të pajisura me shenja dhe sinjale paralajmëruese sipas standardeve europiane të sigurisë.

### Stacionet e ndalimit të trenave

1. St. Durrës
2. St. Shkozë
3. St. Sukth
4. St. Vorë
5. St. Universitetit Epoka
6. Terminali Rinas
7. St. Kashar
8. TTP Tiranë

### Shpejtësitë e trenave sipas segmenteve:

Durrës - Domje I/C - Durrës  
100 km/orë

Domje I/C - Rinas - Domje I/C  
100 km/orë

Domje I/C - Tiranë - Domje I/C  
80 km/orë

### Kohëzgjatja e udhëtimit me tren:

Durrës - Tiranë - Durrës  
26 Minuta

TTP Tiranë - Rinas - TTP Tiranë  
10 Minuta.